

**Prof. dr. Iljaz REXHA**

**VENDBANIMET DHE POPULLSIA ALBANE  
GJATË MESJETËS NË HAPSIRËN E  
MAQEDONISË SOTME**

*(Sipas burimeve sllave dhe osmane)*

Albanët mesjetar apo shqiptarët e sotëm në hapësirën e Maqedonisë së sotme, janë popull autokton që jetojnë me shekuj në hapësirën e saj dhe që kanë vazhdimësi historike që nga antikiteti e mesjeta deri në ditët e sotme. Është i njohur fakti historik se më shumë se gjysma e territorit të Maqedonisë së sotme shtrihet në arealin e Dardanisë antike me kryeqendrën e saj Scupin- Shkupin, kufiri i së cilës shkonte në jug deri përtej Bilassora (Velesi) dhe Astibosi (Shtipi), ndërsa gjysma më e vogël të territorit të saj shtrihet pjesërisht në Thrakinë Perëndimore, e pjesërisht në arealin e Maqedonisë egjejeane, që shkon deri te Gjevgjelia, ku sot kufizohet me pjesën tjetër të territorit të ish Maqedonisë antike (sot krahinë greke) në veri të Selanikut (Thessalnikis). Bazuar në burimet historike të periudhës antike, sllavomaqedonasit e sotëm nuk kanë trashëguar kurrfarë baze historike, etnike, gjenetike, apo linguistike (përveç emërtimit gjeografik), për ta identifikuar vetën me fisin antik protomaqedon të Maqedonisë antike të Filipit dhe Aleksandrit të Madh, sepse siç dihet mirë nga burimet e autorëve antikë, fise sllave në atë kohë gjatë shek. IV-III para erës së re, nuk ka pasur në siujdhesën ballkanike.

Etimologjia dhe semantika e emrit të fisit protomaqedon është e errtë dhe deri më sot ka mbetur e pazbërthyer dhe e pashpjeguar dhe s'ka lidhje me gjuhët sllave. Te disa kronistë mesjetarë për emërtimin gjeografik Maqedonia, është përdorë edhe dubleta e saj Emathia me kuptim Krahinë e Madhe. Por, ekziston mendimi i disa studiuesve si hipotezë që nuk është vërtetuar, se po nga ky fis antik ose nga prijësi i këtij fisi me emrin Maqedon, pikërisht prej emrit etnik, është formuar emërtimi gjeografik Maqedonia dhe më vonë edhe Mbretëria e Maqedonisë antike, që sot e kësaj dite ky toponim gjeografik antik është ruajtur në formë të pandryshuar në emrin e krahinës greke-Macedonia, që gjendet në veri të Thessalnikit. Analogjikisht, sikurse që nga fisi ilir-dardan është formuar emërtimi gjeografik Dardania dhe mbretëria e Dardanisë antike me kryeselinë e saj Scupin-Shkupin, e njëra gjë ka gjasë të ketë ndodhur edhe me krijimin emërtimit gjeografik të Maqedonisë antike.

Periodha antike është shumë e errtë dhe sot për sot edhe më tej mbetet çështje shkencore, për të dëshmuar në mënyrë të saktë, në bazë të gjetjeve të reja arkeologjike, epigrafike, burimeve historike dhe analizave linguistike, se a ishin maqedonët e lashtë me prejardhje ilire-thrake, apo të ndonjë etnie tjetër, por jo edhe greke, sepse helenët ata i kanë quajtur barbarë sikurse fiset ilire-thrakase dhe të tjera fise që nuk e dinin greqishten ose që nuk e kishin gjuhë amtare.

Në nënën tjetër, të dhënat arkeologjike, historike, etnografike, toponomastike dhe linguistike dëshmojnë se albanët mesjetarë apo shqiptarët e sotëm, (sipas arkeologëve dhe medievistëve të huaj dhe vendës: Alojz Benac,<sup>1</sup> Aleksandër Stipčević,<sup>2</sup> Radoslav Katičić,<sup>3</sup> Fanula Papasoglu,<sup>4</sup> Alain Dycellier,<sup>5</sup> K. Jireček,<sup>6</sup> M. Shuffljaj,<sup>7</sup> Duje Rendic Miočević,<sup>8</sup> Skender Anamali,<sup>9</sup> Muzafer Korkut,<sup>10</sup> etj), janë pasardhës të fiseve ilire: të dardanëve, të dasaretëve, peonëve, penestëve, dokleatëve, ardiajve, dalmatëve e shumë fiseve të tjera, së paku prej shekullit XIII para erës sonë, që kanë lindur dhe janë zhvilluar në shumë formacione politike ilire, duke kaluar gradualisht prej stadi të organizimit fisnor në statusin shtetëror të principatave dhe të mbretërive të vogla, por të vërteta në hapësirat e Dalmacisë, Bosnjës, Dokleatisë, dhe të Dardanisë (kjo e fundit përfshinte territorin e Kosovës dhe pjesën më madhe të Maqedonisë së sotme). Ndërsa, fiset sllave, pra edhe sllavo-maqedonasit e sotëm, siç dihet mirë në literaturën shkencore janë me përkatësi sllave, në aspektin gjuhësor, etnografik dhe religjioz me pak dallime, më së afërmi janë me bullgarët e sotëm (sipas disa studiuesve me prejardhje hune-tatare), të cilët u sllavizuan plotësisht në mesjetën e hershme. Kanë depërtuar shumë shekuj më vonë në Ballkan, ndërsa në territorin e Dardanisë kah gjysma e shekullit të IX dhe në fillim të atij të X, kur bullgarët i pushtuan tokat

1 Alojz Benac, Protoiliri i Prailiri, Simpozijum o srednjevjekovnom katunu, Sarajevo, 1966-67.

2 Aleksandër Stipčević, Ilirët, historia, jeta, kultura, Rilindja, Prishtinë 1980.

3 Radoslav Katičić, Antroponimia ilire dhe etnogeneza e shqiptarëve, Revista e Gjuhësisë dhe e Letërsisë, nr. 4, Tiranë, 1972.

4 Fanula Papasoglu, Dardanaska Onomastika, Zbornik Filozofskog Fakulteta knj. VII, Beograd 1966. Dardanaska Kralejevina, Godisnjak nr. V/1 Sarajevo, 1976. Fanula Papazoglu, Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba, Sarajevo, 1969.

5 Alain Dycellier, Les Albanais ont-ils envahi le Kosovo? Extraits, Revue des AAFA- Michel Abain, Du mythe serbs au nationalisme albanais (mbi Kosovën) të botuar në "Le Monde" nr. 5-6 Paris, prill 1981.

6 K. Jireček, Istorija srba Beograd, 1952, knjiga I. f. 85, dhe libri II f. 34. Zbornik Konstantina Jirečeka, knj. I. Beograd 1959, dhe libri II, Beograd 1962.

7 M. Shuffljaj, Biologie des albanischen Volksstammes. Ungarische Rundschau für historische und soziale Wissenschaften, V. Jahrgang, 1 Heft, f. 12. M. Shuffljaj, Povijest sjevernih Arbanasa, f. 61, 62. Historia e Shqiptarëve të Veriut, Serbet dhe Shqiptarët, Prishtinë 1968.

8 Duje Rendic Miočević, Ilirska onomastika, na latinskim natpisima Dalmacije. Split, 1948, f. 5-20.

9 Skender Anamali, Nga Ilirët tek Arbërit, Kuvendi I. i Studimeve ilire, Tiranë 1974, v. II. f. 30-32. i njëjti, Varreza Arbërore pranë Liqenit të Ohrit, në librin "Shqiptarët e Maqedonisë," Shkup, 1994 f. 35-38.

10 Muzafer Korkuti, Ilirët dhe Maqedonia në periudhën pre-e protohistorike, në librin "Shqiptarët e Maqedonisë," Shkup, 1994, f. 19-22.

kryesisht të banuara me popullsi albane dhe arumune, që atëherë ato ishin nën sundimin e Bizantit. Siç dihet nga burimet mesjetare, territori prej Nishit (Naisus), Prishtinës, Shkupit deri te Shtipi (Astibos) e Velesi (Bilazora), kishte qenë i përfshirë në territorin e Dardanisë antike e cila prej shek. V dhe gjatë tërë mesjetës së hershme u përfshinë nën sundimin e Bizantit deri në dekadën e parë të shekullit të XI (850-1018), ishte nën sundimin e Mbretërisë bullgare, pothuajse gati 150 vjet territoret e Maqedonisë dhe të Kosovës së sotme mbetën nën sundimin bullgar, kur pas 150 vjetëve Bizanti arriti që këto territore t'i rikthejë nën sundimin e vet shtetëror të cilat i mbajti deri kah gjysma e shekullit të XIII, kur edhe u pushtuan nga shteti i Rashkës i formuar nga dinastia e Nemanjiçëve me prejardhje të errtë, fillimisht e ardhur nga Doklecia, Zeta mesjetare. Mirëpo, sipas të dhënave më të reja të disa autorëve serbë, ata definitivisht përfshihen nën sundimin dhe administratën e shtetit mesjetar serb të Rashkës vetëm pas gjysmës së dytë të shek XIII e jo në fund të shek. XII (1196) siç është shkruar dhe pohuar nga historiografia borgjeze dhe bashkëkohore serbe, sepse ajo periudhë kohore kishte karakter të pushtimeve të përkohshme, meqë Maqedonia e sotme edhe Kosova dejure dhe defacto deri në gjysmën e dytë të shekullit XIII gjendeshin nën sundimin dhe administrimin e Bizantit. Nga këto të dhëna kuptohet se hapësira e Dardanisë (Kosova dhe Maqedonisë së sotme), më shumë kohë gjendeshin nën sundimin e shtetit bullgar, gati 150 vjet më pak ndërprerje, se sa nën sundimin serb. Edhe shtresa e parë e toponimeve sllave në Maqedoni, Kosovë dhe në Arbërinë mesjetare ishte formuar nga administrata mesjetare bullgare e pastaj ka vazhduar me një intensitet edhe më të madh ajo serbe, e cila me forcë objektet e kulturës materiale të arkitekturës romano-katolike si edhe bazilikat e stilit gerko-bizantin i përvetësoi dhe u dha ngjyrë sllave, duke përdorë metodat më të egra ndaj popullsisë autoktone albane dhe arumune për t'i konvertuar dhe sllavizuar me dhunë.

Depërtimi i sllavëve në tokat e banuara me popullsi albane dhe vllehe shkaktoi shkatërrime dhe masakra të mëdha, duke i zhvendosur banorët autoktonë nga tokat e tyre pjellore të cilët qenë të detyruar të strehohen me shekuj nëpër shpella dhe male të pakalueshme, për të mbijetuar. Sipas ballkanologut të njohur Millan Shuffaj,<sup>11</sup> historian dhe etnograf i shquar i cili thekson se vendosja e sllavëve në Ballkanin Perëndimor kishte rënë mbi popullsinë albane si një sopat që i kishte prerë në veri dhe në jug disa nga degët kryesore të trungut të tij dhe i kishte ngushtuar brenda një territori shumë më të vogël. Edhe Konstantin Jireček,<sup>12</sup> historian i mirënjohur me prejardhje çeke, duke folur për ilirët, ai mendonte se ilirët

11 Milan Shuffaj, *Povijest sjevernih Arbanasa...* f. 61-62.

12 Konstantin Jireček, *Istorija srba Beograd I...* f. 154.

gjatë periudhës romake, gjysmë të romanizuar ishin të parët e albanëve mesjetar, që gjatë depërtimeve të popullsisë sllave, siç shkruan ai, ata prej territoreve ku banonin deri atëherë, midis hapësirës së Dalmacisë dhe Danubit, u shtynë ma në jug të ujdhesës së Ballkanit. Shuflaj dhe Jireçek kanë pohuar në studimet e tyre se në mesjetë të gjitha krahinat e përfshira në katërkëndëshin Ohër-Vlorë-Tivar-Prizren me disa degëzime të tyre larg në veri të Prizrenit (të Kosovës Verilindore-I.R.) ishin troje të albanëve (Arbanasa). Ata kishin shkruar se albanët kishin jetuar në mesjetë edhe në qytetet e Kosovës dhe të Maqedonisë se sotme, por asgjë nuk thanë për albanët që jetonin nëpër vendbanimet rurale, meqë nuk i posedonin regjistrat kadastralë të shek. XI-XVI të administratës osmane. Prandaj, teza e tyre me zbulimin e regjistrave kadastralë osmanë të shek. XV-XVI, për vendbanimet dhe popullsinë albane nëpër fshatra të Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme është tejkaluar, qysh para 4 dekadash. Meqë këto burime arkivore të dorës së parë vërtetojnë në mënyrë bindëse se popullsia albane edhe para depërtimit të osmanlinjve në Ballkan, banonte në mesjetë edhe në vendbanimet rurale në tërë hapësirën gjeografike prej Nishit (Naisus) e përtej Shtipit (Astibos), dhe Bilazorës-Velesit të Maqedonisë së sotme. Po ashtu, sipas këtyre regjistrave osmanë një numër i konsiderueshëm i vendbanime mesjetare në rajonin e Radomirit dhe të Qystedilit, sot në Bullgari, ishin të banuara edhe me popullsi të krishterë albane. Të dhënat e defterëve kadastralë osmanë si duket, po e vërtetojnë tezhën e Jireçekut i cili pohonte se Gryka Suki (Klanac Succi), më vonë e quajtur Porta e Trajanit (Trajanova Kapija), prej asaj kohe ishte kufi ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, Thrakia ka qenë në kuadër të praefectus praetoria Orienttis, ndërsa e tërë pjesa tjetër e Gadishullit deri në Danub e në brigjet jugore të Peloponezitet ka qenë në kuadër të praefectus praetoria Illyrici.<sup>13</sup>

Sipas bizantologut francez, Alain Ducellier 13/a, sllavët-serbët janë pushtuesit më të vonshëm të Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme. Ai bënë pyetje, nëse serbët gjatë shekullit XIII-XIV, kishin sunduar dhe ishin shumicë në territorin e Dardanisë (Kosovë-Maqedoni), atëherë duhet pyetur se kush banonte përpara sllavëve ardhacakë në territorin e lartpërmendur. Gjithkush e dinë se sllavët janë popullsi indoeuropiane, që më së voni erdhën në Ballkan dhe pushtuesit e fundit të Kosovës dhe të Maqedonisë, janë serbët e Rashkës. Gjithashtu, dihet se në atë kohë për shumë shekuj romanizimi nuk kishte mundur t'i zhdok popullsitë autoktone: dakët në Rumuni, thrakët në Bullgari, fiset ilire në Albani, Maqedoni dhe Dalmaci, pohon Alain Ducellier. Mirëpo, asimilimin dhe

13 Zbornik Konstantina Jireçeka, I, SAN, Posebna izdanja, Odeljenje društvenih nauka, Nova serija, knjiga 33. Beograd, 1959, f. 81-129.

sllavizmin e plotë të popullsisë autoktone paleobalkanike dhe parasllave në Bosnje dhe në Damalmaci, ndërsa pjesërisht në Diokleci dhe Dardani e bënë pikërisht fiset e shumta sllave, me ndihmën e hunëve, avarëve e fiseve tjera barbare, që nuk arriti dot as Perandoria Bizantine t'i përballoj dhe t'i ndaloj sulmet e tyre shkatërruese dhe të tmerrshme, kudo që depërtuan lanë gërmadha dhe shkretëtira.

Siç, e kemi cekur edhe pak më parë, sllavo-serbët e Rashkës, pas sundimit të bullgarëve dhe përsëri të atij bizantin në tokat kryesisht të banuara me popullsi albane, mezi arritën, vetëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIII dhe fillimit të atij të XIV, përfundimisht ta vendosin pushtetin dhe administratën e tyre në hapësirën e Kosovës dhe Maqedonisë së sotme. Ata bënë ndryshime të mëdha në jetën shoqërore të popullsisë vendase albane dhe arumune si në aspektin material, social, ashtu edhe në atë religjioz sepse shumica e kishave qofshin ato të rritit katolik-romanlatin apo të rritit ortodoks-grekobizantin u uzurpuan dhe u shndërruan në kisha pravosllave, ku liturgjia mbahej vetëm në gjuhën sllave. Ky qe, përveç faktorëve tjerë politikë, shoqërorë dhe ekonomikë, faktori kryesor për asimilimin dhe sllavizimin e popullsisë parasllave. Administrata dhe kisha sllave ka lënë gjurmë të thella në të gjitha fushat e jetës shoqërore, por këto gjurmë më së shumti mund të shihen në lëmin e ndryshimeve të toponimeve parasllave dhe sidomos në ndryshimin e antroponimisë (emrave) të njerëzve të popullsisë vendëse albane, e sidomos të asaj villehe që sipas arkeologut Alojz Benac, është popullsi e romanizuar ilire e cila fatkeqësisht, gati krejtësisht, ishte sllavizuar gjatë mesjetës dhe ishte konvertuar në fenë ortodokse. Edhe mendimi i shumë studiuesve vendas si dhe të huaj, e sidomos ai i bizantologut francez Allain Ducellier, (Alen Dysile), historianit anglez Noel Malcolm,<sup>14</sup> medievistëve Jireček e Shuflaj është se së pari, gjatë sundimit mesjetar bullgar, në tokat e banuara me popullsi albane dhe arumune është vënë shtresa e parë e toponimeve sllave. Edhe gjatë sundimit mesjetar serb edhe me më shumë intensitet vazhdon sllavizmi i emërtimeve të vendbanimeve në hapësirën e Ballkanit, ku përfshihej edhe Dardania. Kështu që gjatë mesjetës, në hapësirën e Arbërisë mesjetare, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së sotme, deri përtej Selenaukut të Greqisë u bë edhe sllavizmi i toponimisë parasllave, siç shihet nga dokumentet dhe burimet shkrimore mesjetare: nga Alpes Albanicae në Prokletije Planina, nga Durrahium –Durrës në trajtën sllave Draç, nga Berat në Beligrad, nga Shkodra në Skadar, nga Ulkinon -Ulkos në Ulcinj, nga Doclea në Zeta, nga Krahina Palabrdhi në Belopavliç Zhupa, nga Buna në Bojana, nga Bardusi në Belosh, nga Bardoniq-Beliç, Bardosan-Lipovac, nga Guri Kuq-Crveni Kamen, nga Gurizi në Kamenica, nga

<sup>14</sup> Noel Malcolm, *Kosovo A Short History*, First published 1998 by Macmillan, London, f. 20-50.

Ujmir në Dobra Voda, nga Scupi-Shkupi në Skopje, nga Bardofci-Gjorgje Petrov, nga Bardarios në Vardar, nga Kumanova në Nagoriç, nga Monostiri në Bitola, nga Bilassora në Veles, nga Dibra në Debar, nga Kriçova- në Kiçevo, nga Malesheva në Malesh-Pllania, nga Thessalonikis në Solun nga Byzantion-Kostantinopolis në Carigrad, nga Filippolis në Plovdiv etj.

Autoktonia e popullsisë albane në Ballkan është dëshmuar nga studiues të huaj dhe ata vendës edhe përmes toponimeve, oronimeve dhe hidronimeve parasllave që kanë marr formën nëpërmjet gjuhës shqipe: Naissus-Nish, Scupi-Shkupi, Astibos -Shtip, Scardus-Sharr, Ulpiana-Lypian, Scodra-Shkodër, Lissus-Lesh-Lezhë, Drivastum-Drisht, Drinus-Drin, Scumbus-Shkumbi, Barbana- Buna etj. Duke u bazuar në këto të dhëna të toponomastikës antike linguistët e shquar si austriaku N.Jokl, gjermani G. Waigand, H. Baric<sup>15</sup> dhe E. Çabej<sup>16</sup>, kanë përkrahur tezën se ishte pikërisht Dardania e përcaktuar si zonë ndër të tjera nga emra si Nish-Shkup-Shtip, që përbënte një vatër të popullsisë së lashtë albane. Një fakt tjetër që ishte konstatuar sipas dëshmive toponomastike nga linguisti i njohur holandez N. Van Wejk,<sup>17</sup> se në mesjetën e hershme popullsia serbe ishte e ndarë nga ajo bullgare, prej një popullsie josllave, shpjegohet me praninë e popullsisë albane. Nga kjo rrjedhë se këto troje prej kohësh kanë qenë të banuara nga albanet mesjetarë, nëpër gojën e të cilëve kanë kaluar këta emra antikë për të arritur në formën e sotme.

Sipas studiuesit gjerman G. Stadtmuller, është fakt i pamohueshëm që këto vendbanime ishin emra të qyteteve antike që edhe sot ruajnë dëshmitë e popullsisë albanofolëse, tregon se kjo popullsi nuk përbëhej kurrsesi nga barinj të struktur në zona malore, por nga popullsi që njihnin një jetesë të përparuar urbane.<sup>18</sup>

Në saje të kërkimeve arkeologjike të bëra nga arkeologët sllavo-maqedonas D.Simoska, V.Sanev<sup>19</sup>, B. Kitonovski dhe arkiologut serb M.Garashanin etj., në territorin e Republikës së Maqedonisë sipas vlerësimit të arkeologut Muzafer Korkuti, që ju bënë këtyre kërkime, ai thekson se një vend të veçantë zënë kultura materiale e krahinës së Ohrit, ndërsa Lugina e Pollogut edhe pse nuk është hulumtuar ka shumë mundësi të pritet një zhvillim i ngjashëm me kulturën materiale të krahinës së Ohrit që janë të ngjashme me kulturën materiale të Shqipërisë Qendrore.<sup>20</sup>

15 Henrik Baric, *Istorija Arbanaskog Jezika*, Sarajevo, 1959, f. 19-35. *Hymje në Historinë e Gjuhës Shqipe*, Prishtinë 1955, f. 48-50.

16 Eqrem Çabej, *Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe*, Tiranë 1960, f. 20. Eqrem Çabej, Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe, Kuvendi i parë i studimeve ilire, II, Tiranë, 1972, f. 7-22.

17 Van Wejk, në *Madedeelingen der koninklijke Akademie van Wetenschappen Afdeling Letter kunde*, Deel 55, Serie A: nr. 3 f. 68.

18 G. Stadtmuller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden 1966, f. 141, 147, 154, 159 etj. *Istorija naroda Jugoslavije*, knjiga II. f. 791.

19 D. Simoska, V. Sanev, *Neolitiska naselba Veluska tumba kaj Bitola*, "Makedoniae Acta Arhaeologica", nr. 1, 1975, f. 25-39.

20 Muzafer Korkuti, vep. e cituar f. 19-22.

Duke u marrë me problemin etnik të bartësve të kulturës së tumave që janë gjetur në vendet e quajtura Orlllova Çuka e Radanja në Maqedoninë e sotme, arkeologu serb Milutin Garashanin shkruan: "Përkatësia etnike e bartësve të kësaj kulture nuk ndesh në vështësi të mëdha, vetë zakoni i varrimit flet për përkatësinë ilire të kësaj ane e cila vërtetohet edhe nga të dhënat materiale. Qeramika e këtyre nekropoleve (enë me një ose dy vegje), mbi grykë oblike, zbukurimi me trekëndësja të ngjizura etj., tregon se ka lidhje të ngushtë me gjetjen e grupit të kulturës materiale të Suharekës në Kosovë, të cilat ju përkasin pa dyshim ilirëve dhe me shumë gjasë dardanëve, pohon Garashanin.<sup>21</sup>

Objektet e gjetura në varrezat e Shën Erazmit të Radolishtit e të lokaliteteve të tjera të rrethinës së Ohrit<sup>22</sup> tregon se prania e kulturës albane në zonën për rreth liqenit të Ohrit është krejtësisht e shpjgueshme. Në lashtësi i takonte fisit ilir të dasaretëve. Si e tillë ajo zonë ka qenë përfshirë në trevën e banuar nga ilirët, pasardhës të të cilëve janë arbanët mesjetar. Këta të fundit edhe në këtë rajon kanë qenë bartësit e kulturës materiale e shpirtërore të zbuluar në vendet Orovnik, Shën Erazëm, Radolisht dhe në lokalitete të tjera të panjohura. Kjo sipas arkeologut të njohur Skender Anamali<sup>23</sup> do të thotë se kultura e varrezave të lokaliteteve të mësipërme si fibulat, vathët, rrathët e qafës, varëset e broshët, enët prej balte, gjerdanet e rruazave e deri te thikat prej hekuri nuk i takojnë fare fisit sllav, sikurse është shprehur një studiues sllav, por këto i takojnë popullsisë autoktone arbërore, pra shqiptarëve të sotëm, pasardhës të ilirëve, pohon ai.

Në kohën e sundimit të anzhuinëve në trojet albane një pjesë e të cilave ndodhën në Maqedoninë e sotme, disa fisnikë albanë të këtyre viseve shfrytëzuan dobësimin e Bizantit dhe u shkëputën nga pushteti qendror bizantin. Siç ishte rasti me krahinat e Pollogut të Tetovës, të Dibrës e të Ohrit.<sup>24</sup>

Në shekujt e XII e XIII<sup>25</sup> disa prijës të fiseve albane, të cilët patën shërbyer si stratotë ose kalorës e komandantë në ushtrinë e Bizantit, e më vonë në atë të Anzhuinve, arritën të bëhen fisnikë të pavarur. Në vitin 1273 mbreti i Anzhuinëve nga Sicilia Karli i I-rë emëroi Pal Gropën epror dhe administrator të viseve që gjendeshin mbi Radikën e Epërme e të Poshtme në fshatrat përreth. Këta eprorë zyrtarë të lartë albanë, arritën në shekullin e XIV poste të larta qeveritare.

21 M. Garashanin, V. Sanev, D. Simoska, B. Kitonovski, *Predistoriski kulturi vo Makedonija*, Shtip, 1971, D. Simoska, *Praistorija vo centralna Pelagonija*, Bitola, 1976.

22 B. Lahtov, *Les Bijoux des habitants archeologiques datant du haut Moyen Age dans la region de Ohrid*, në "Ohrid" 1961, f. 42, tab. I, 4.

23 Skënder Anamali, *vep. cit.*, f. 35-38.

24 *Historia e Popullit Shqiptar, vëll. I*, Prishtinë 1968, f. 178-185, Vizantijski izvori za Istoriju Naroda Jugoslavije, Vizantoloski Institut-SANU, tom. VI, knj. 18, Beograd, f. 309-310.

25 J. G. Hahn, *Ptuovanje kroz poreçinu Drina i Vardara*, Beograd, 1876 f. 489, 502, 703.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV fisnikët e Principatës së Gropajve i zgjeruan zotërimet e veta edhe në anën jugore. Këtë zgjerim e bënë sidomos në kohën e Andrea Gropës i cili me dobësimin e shtetit mesjetar serb pas vdekjes së mbretit Dushan, e forcoi dhe zgjeroi gradualisht principatën e vet në krahinën e Ohrit<sup>26</sup> (me qendër Ohrin) Pas vdekjes së fisnikut Vukashin dhe pas Betejës së Maricës të vitit 1371, Andre Gropa shpallet i pavarur, kurse nga viti 1378 përmendet me titullin dukë ose kont i madh. Në selinë e këtij princi alban kishte një farkëtari për prerjen e monedhave<sup>27</sup> e cila vazhdoi të punonte edhe një kohë pas depërtimit osman. Zahari Gropa si pasardhës i Andrea Gropës, njëherit ishte bashkëluftëtar i Skënderbeut dhe kishte marrë pjesë në luftërat e këtij strategu të famshëm ushtarak në Dibër, në Ohër, Strugë,<sup>28</sup> në Gostivar, në Luginën e Pollogut të Tetovës etj. Principata e Gropajve, në çerekun e katërt të shekullit të XIV, përveç në pjesën me të madhe të Maqedonisë Jugperëndimore, ajo shtrihej në veri deri në zotërimet e Blinishtëve në Mirditë, ndërsa në jug deri në zotërimet e Arianitëve të Devollit dhe nga lindja shkonte deri në Prespë. Pas rënies së tokave arbërore nën sundimin osman, fisnikët e dinastisë së Gropajve, Muzakajve, Zenebishëve dhe fisnikëve tjerë të Strugës të Ohrit dhe të Tetovës disa vazhdojnë rezistencën, e disa si Zenebishtët që më herët i kishin zotërimet e veta edhe në Pologun e Tetovës bien nën vazalitetin e shtetit osman dhe me pranimin e islamit. Ata inkuadrohen në sistemin ushtarak të timarit osman dhe për shërbimet që kryenin ndaj shtetit osman, ata fitonin timare (feude) e pozita tjera të larta shoqërore në administratën osmane siç ishte rasti me njërin prej trashëgimtarëve të Principatës së Gjon Zenebishit me Hasan Zenebishin që ishte regjistruar në regjistrin kadastral të vitet 1455,<sup>29</sup> ishte emëruar subash, qeveritar në vilajetin e Tetovës, si titullar i lartë administrativo-ushtarak posedonte haset (pronat) e tij, që përveç Tetovës me status qyteze dhe tregu, përfshinin edhe 8 fshatra duke përfshirë vendbanimet më të mëdha siç ishin Gostivari dhe Sobri.

Para dy dekadash pikërisht në vitin 1992 në rrethinën e qytetit antik Astibos të Dardanisë antike (Maqedonia e sotme) në Nekropolin e quajtur Suburbium, në një varrezë nga periudha e shek. III-IV të erës sonë, nga një grup arkeologësh maqedonas (V Senev, M Ivanovski, Zh. Viničić dhe G. Spaskovska-Dimitrovska) u zbulua dhe u identifikua varreza me pllakën e gurit me mbishkrimin përkujtimor grek, që në këtë rast në mungesë të alfabetit grek dhe të atij cirilik e paraqesim transkribimin dhe

26 Millan Shufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 227.

27 Nebi Dervishi, *Emokultura e Fushëgropës së Ohrit*, l. f. 72.

28 Ali Vishko, *Popullata e Strugës në shek. XV*, sipas vakafnamesë së Sinanudin Jusuf Celebiut, në librin "Shqiptarët e Maqedonisë", Shkup, f. 127-129.

29 Hazim Sabanovic, *Krajiste Isa- Bega Ishakoviça*, Zbirni Katastarski Popis Iz 1455, godine, Sarajevo, 1964, f. 67-72.



përthimin e autores maqedonase vetëm me shkrimin latin: Na svoeto dete Flavij Albanos. Emilijan Albanos za spomen. Flavio Albano, të birit të vet Emilianos Albanos për përkujtim. Njoftimet e para për këtë varrezë antike si zbulim arkeologjik i publikoi Gordana Spasovska-Dimitroska.<sup>30</sup> Këtë mbishkrim të autores në fjalë e bëri të ditur në gjuhën shqipe studiuesi Qemal Murati.<sup>31</sup> Pas përmendjes së parë të fisit Albanoi nga ana e gjeografit të Aleksandrisë, Klaudi Ptolemeos në shek. II të erës së re, kjo është dëshmia tjetër e dytë se emri etnik i albanëve antikë ka lidhje dhe vazhdimësi pandërprerë deri në mesjetë e këtë na e dëshmojnë edhe shumë vendbanime me etnonimin Arban si edhe me vendbanimin mesjetar Alban<sup>32</sup> të Prokupit që në mesjetë ishte deformuar nga administrata sllave në Alabana. Po kështu, kemi edhe vendbanimin tjetër me formën vllëhe Albince marr nga etnonimi i mirëfilltë Alban, që gjendet te Jakupica e Tetovës. Të gjitha toponimet që na dalin me bazën e etnonimit: Alban-Arban dhe Arvan janë të periudhës romake dhe bizantine, pra parasllave shumë më të vjetra se sa na dalin në shkrimet dhe burimet mesjetare.

Për të dëshmuar se në hapësirën e Maqedonisë së sotme se edhe para shekullit të XIV-XV ka jetuar popullsia autoktone albane, kemi hulumtuar në burime shkrimore dhe në dokumentet sllave në sasi të kufizuar nga shekulli i XIII dhe XIV, por më së shumti kemi shfrytëzuar regjistrat kadastralë osmanë të shek XV për territorin e Maqedonisë së sotme, ku në mënyrë shumë të qartë janë regjistruar disa vendbanime mesjetare albane mbi substratin iliro-arban të protoshqipes dhe me etnonimin popullor Arban-Alban. Toponimet e para me këtë etnonim përmenden në dokumentet sllave me formën sllave Arbanashki Potok,<sup>33</sup> Lugu i Arbneshit në Kosovë, pikërisht në vitin 1253-1254 në kartën e Knez Miroslllavit, pastaj vendbanimi Arbanashka e Kumanovës<sup>34</sup> del i shënuar në diplomën e mbretit serb Millutin nga viti 1330. Ky vendbanim përmendet po ashtu në defterët kadastralë osmanë për Sanxhakun e Qystendilit të shekullit të XV dhe të atij XVI. Vendbanimi siç shihej është shënuar me trajtën e hershme bullgaro-sllave Arbanashka dhe Arbanashko, formantet e diminutivit sllav-ka-ko, me kuptim fshati i Albanëve .Këtë trajtë bullgare sllave e regjistroi edhe administrata osmane pa e ndryshuar fare.

30 Gordana Spasovska-Dimitroska. Grobot na pisarot od Stobi. "Macedoniae acta archeologica" nr. 14, Makedonsko Arheolosko Drustvo. Skopje, 1996.

31 Qemal Murati. "Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve" Tetovë, 1999. f. 31-32.

32 Basbakanlik Osmanli Arshivi. Istanbul. Rumeli timar defteri Nr. 167. Më tej shkurtesa. BOA.

33 St. Stojanović. *Stari srpski hrisovulj, ljetopisi rodoslovi, spominik III*. Beograd, 1980. f. 9. Skender Gashi. *Prania e emosit shqiptar në Kosovë gjatë shek. XIII-XIV*, në dritën e burimeve krishtere serbe. Onomastika e Kosovës. Instituti Albanologjik. Prishtinë, 1979. f. 61-62.

34 Miodrag Purkovic. Popis sela u srednjevekovnoj Srbiji. Godisnjak Skopskog Filozofskog Fakulteta, Skopje. 1940 f. 58-59. BOA. Defter-i esami-i voynugan-i liva-i Kustendil.... nr. 21. Tapu defteri, nr. 74.

Kjo na dëshmon se ky toponim dhe toponimet tjera me etnonimin Arbanas janë krijuar shumë më herët , para vendosjes së administratës serbe të Nemanjiçëve në territorin e Maqedonisë së sotme, pra në kohën e sundimit bullgar diku gjatë shekujve IX-X, kur edhe së pari këtë vendbanim alban e emërtoi administrata bullgare e asaj kohe. Në atë kohë sikurse edhe në mesjetën e hershme , shqiptarët e këtij vendbanimi dhe të trojeve të tjera veten e quanin me emrin etnik Arban. Ky vendbanim përmendet në shek. XV në defterë të timareve, por pa të dhëna antroponimike të banorëve, ndërsa në shekullin e XVI kishte 22 shtëpi dhe 14 beqarë, përveç kryefamiljarëve që mbanin thjeshtë emra tipikë sllavë-bullgarë, kishte edhe kryefamiljarë që ende mbanin emra të krishterë të formës shqipe si: Boja, Tuna, Niko, Stepa, Dano, etj. Ky vendbanim sot e kësaj dite ekziston 27 km në verilindje të Kumanovës. Popullsia e tij ishte sllavizuar jo vetëm në aspektin onomastik, por edhe në atë etnik dhe tani aty jetojnë vetëm sllavo-maqedonasit.

Vendbanimi tjetër mesjetar i shekullit XIV dhe XV në rrethinën e Shtipit ishte formuar sikurse toponimet tjera me bazën arban, natyrisht pas pushtimit të këtij vendbanimi nga ana e bullgarëve gjatë shekullit IX dhe X përkatësisht në kohën e sundimit të Simeonit (893-927) , kur përveç territorit të Maqedonisë të sotme edhe Kosova ishte nën sundimin e shtetit bullgar. Toponimi është regjistruar edhe në defterin sumar osman të shekullit XV me formën Arbanash, ndërsa një shekull më vonë (XVI) del i shënuar me dy emra: Zhiganci dhe me emrin tjetër më të vjetër Arbanash.<sup>35</sup> Forma më e re Zhiganci edhe sot e kësaj dite ekziston në komunën e Koçanës, ndërsa toponimi me emrin Arbanash është zhdukur. Nga kjo rezulton se emrin e këtij vendbanimi e me formën sllave Zhiganci e kishte ndryshuar administrata sllave paraosmane e ajo administrata osmanoturke siç pohojnë disa autorë sllavo-maqedonas. Në këtë vendbanim në atë kohë dominonin emrat e krishterë, por kishte kryefamiljarë edhe me emra të përzierë krishtero-sllavë. Sipas leximit tonë disa kryefamiljarë në mesin e emrave të shumtë sllavë, ende mbanin patronime të krishtera tradicionale albane, siç ishin: Pavël Spano, Niko Tola, Niko Dimitri , Gjiro Prono (Proni), Stepan Pronko (Proni). Në vitin 1350 mbreti serb Dushani në krisobulën e tij ia regjistroi pronësinë e tokave fisnikut Ivanko Probishtiloviçit, si bashkinë që i kishte blerë në qytetin e Shtipit dhe jashtë tij së bashku me disa bujkrobër. Në mesin e këtyre bujkrobërve përmendën edhe këta persona: Gjergj Dankovic, Mano Vllah-u, Gjin Arbanas-i, Stan Godoe, Vllçina, Dragoslav Vllah-u , Radovan Golemçik dhe Dragoslav Srblijin me vëllanë. Nga këto të dhëna antroponimike shihet

35 BOA. Defter-i esami-i voynugan-i liva-i Kustendil, nr. 21 f. 186. Truski dokumenti opsiren popisen defter br. 85, M. Sololoski, Stip i Stipsko vo tekot na XVI vek, Spisanic na Sojuzot na istorijskite drustava na Makedonija Skopje, 1974, br. 2. f. 144.

se Gjin Arbanasi dhe Stan Godoja ishin me prejardhje albane dhe nga fshati Arbanas i Shtipit, dy të tjerë me prejardhje vllahë dhe dy të tjerë me prejardhje sllave-serbe. Andaj Shtipi dhe rrethina e tij në atë kohë paraqiste një mozaik të grupeve të ndryshme etnike, ku gërshetoheshin etnoset: arumune, albane, maqedone, bullgare dhe serbe.

Në rajonin e Shtipit në defterët osman të shekullit të XV na del i regjistruar edhe një vendbanim tjetër me etnonimin popullor arban, Arbanasi<sup>36</sup> dhe me emrin tjetër sllav Zubac. Po ashtu, shihet qartë se toponimit në fjalë i është ndërruar emri nga administrata sllave, para vendosjes së administratës osmane në Maqedoninë Lindore.

Në rrethinën e Ohrit na del një vendbanim me formën arumune-sllave me bazën e protoshqipes Arbinovo.<sup>37</sup> Emri i këtij topiku lidhet me bazën etnike Arban-Alban, formuar me ndërmjetësimin e rumanishtes Arbin me ndërmërrimin fonetik të kësaj gjuhe a:i dhe sufiksit sllav-ovo, siç e ka thënë onomasti Petar Ilijevski dhe nuk ka të bëjë me format H`rbino dhe Harbino. Forma vllahë arbinas-arbines tregon se banorët e këtij vendbanimi mesjetar ishin me prejardhje etnike arbane, siç dëshmon edhe vetë topiku Arbinovë e jo banorët e ardhur nga Shqipëria e sotme, sikur që gjykojnë studiuesit sllavo-maqedonas.

Në rajonin e Manastirit në naihijen e Lerinit në defterin osman të shekullit të XV ishte regjistruar edhe vendbanimi tjetër me emrin Arbino, i marrur nga forma e më hershme arumune Arbinesi të cilin gjatë regjistrimit administratë mesjetare sllave ia kishte hequr prapashtesën vllahë-esi dhe kishte shënuar me formantin e sllavishtes –o duke e përfutur në Arbino. Në verilindje të Kërçovës në defterin osman të shek. XV është regjistruar vendbanimi me emrin Rabetino. Emri i këtij topiku rrjedh nga baza e substratit arb me anë të metatezës së njohur rab dhe me prapashtesën –ino, nga një paraformë Arbet-ino, sikurse që në mesjetë, shpeshherë nga administrata sllave ishte përdorë forma e vjetër sllave me metatezë- Raban për banorët arbanë dhe për Vendin e Arbanëve- Rabania në vend të formës shqipe Arbania .

Në afërsi të Prilepit, ndërmjet fshatit Dubjaçan dhe Nebregovë, në monumentet shkrimore në krisobulat e mbetët Dushan të vitit 1334-1335,<sup>38</sup> përmendet mikrotoponimi Arbanasi si dhe emri i fisnikut me origjinë albane Teodor Zguri. Në afërsi të një burimi të Nebregovës është një vend që nga banorët sllavo-maqedonas të kësaj ane quhet Kisha Latine-Katolike (Latinska Crkva),<sup>39</sup> prej së cilës sot ka mbetur vetëm nomenklatura gjeografike.

36 BOA, Rumeli timar defteri, nr. 167.

37 BOA, Turski dokumenti, opsiren popisen defter, za Ohridski Sandazak od 1589, Skopje.

38 Spomenici za srednovokovnata i ponovata istorija na Makedonija, tom. IV, Skopje, 1981, f. 84-90.

39 Qemal Murati, Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve, Tetovë f. 38.

Në vendbanimin Krushevë të Maqedonisë së sotme ishte regjistruar toponimi si lagje me emrin Arbines, dukshëm e banuar me popullsi arumune e cila e mban edhe sot e kësaj dite formën arumune Arbines që rrjedh nga forma e mirëfilltë shqipe Arban.

Në vendbanimin Vrapçisht të Gostivarit del i regjistruar mikrotoponimi me emrin Arbon-Arban, deri më sot nuk është bërë unifikimi i tij. Në një vendbanim të rrethinës së Prilepit ishte regjistruar toponimi me emrin Arbinko. Në rajonin e Shtipit në fshatin Zletovë del i regjistruar toponimi si mëhallë me emrin Arvanik,<sup>40</sup> me bazën e apelativit të protoshqipes arb, arban, por me zhvillimin fonetik të greqishtes nga rb-rv dhe me prapashitesën ik, është përfuar në formën Arvanik, lagje kjo e banuar me popullsi autoktone albane dhe e emërtuar në këtë formë nga administrata e periudhës së Bizantit .

Përveç vendbanimeve të lartpërmendura me etnonimin arban-alban në defterët e shek. XV janë regjistruar edhe disa toponime tjera parasllave, vendbanimi mesjetar Bardofci,<sup>41</sup> i Shkupit i sajuar mbi substratin iliro-arban nga Bardofci. Vendbanimi tjetër mesjetar i regjistruar me formën sllave është Bardova, nga apelativi i protoshqipes bardh+ova, në rrethinën e Shtipit, i cili deri më tani ka mbetur i pa ubifikuar. Apelativi Bard përmendet në një kartë të mbretit Dushan me të cilin ky vërtetonte të gjitha dhurimet e paraardhësve dhe i shtonte edhe te vetat Manastirit të Hilendarit në Atos të Greqisë, po ashtu në këtë dokument përmendet edhe një mikrotoponim me emrin Bashtina (Bardina) e Bardhit.

Këtu po përmendim vetëm disa toponime tjera parasllave si vendbanime mesjetare në territorin e Maqedonisë, siç ishte Dardashi<sup>42</sup> i Ohrit.

Në regjistrin e vitit 1451-53 ishte regjistruar fshati me formën Geraj, në rrethinën e Shkupit si çiflig i Jurukëve pa banorë. Në regjistrin e vitit 1467-68 është regjistrua me të njëjtën formë Geraj, por tani ishte i banuar me 7 shtëpi myslimane. Edhe në rrethinën e Preshevës përmendet në dokumentet sllave të shek. XIV, një fshat me emrin Geraj sipas patronimikut Geraj i fshatit Norçë. Sipas studiuesit të shkencave albanologjike prof. Rexhep Ismajli, sufiksi-aj, është i zakonshëm dhe autokton në patronimikën albane: Binaj, Derraj, Palaj, Dushkaj. Edhe rrethinën e Tetovës ishte regjistrua fshati me formën Gare. Ky toponim sipas prof. Rexhep Ismajli, mund të shpjgohet vetëm përmes shqipes garc - karç, ku është bërë shurdhimi i g-së nistore, që nuk është i rrallë në

40 BOA. Turski dokumenti, opsiren popisen defter od XVI vek, za Qustendilskiot Sandzak, tom. V. knj. II. Skopje 1980 f. 88.

41 BOA, Rumeli tahrir defteri nr. 12, Turski dokumenti-opsiren popisen defter od XV vek, tom III, Shkup 1976, f. 176. TD. Nr. 4, f. 437.

42 BOA, Rumeli timar defteri , nr. 7. f. 15-20.

gjuhën shqipe. Fjala karç ndihet edhe sot në të folmen e Preshevës, është e gurrës shqipe dhe ka shërbyer për emërtime vendesh që në kohët e hershme në të gjitha viset.

Oronimi Malësia e Strugës, vendbanimet Malçishte<sup>43</sup> - (Malishte) dhe Guh-Maleva<sup>44</sup> formë tautologjike, nga apelativi guh i persishtes me kuptim mal dhe fjala shqipe mal në rrethinën e Shkupit, pastaj vendbanimi mesjetar Malesheva,<sup>45</sup> i Shtipit dhe oronimi me emrin Malet e Maleshevës që përdoret më vonë si formë tautologjike si Maleshevski Planini i përkthyer nga administrata sllaveo-maqedonase. Pastaj kemi vendbanimin tjetër në rrethinën e Kumanovës i regjistruar me formën e shtrembëruar sllave Malotina,<sup>46</sup> nga apelativi i shqipes malet+ina prapashtesë sllave, meqë një toponim tjetër si ajkonim e hasim në Toplicë të regjistruar një herë me formën Malet- in dhe herën tjetër me formën Malet-ino, andaj këtu kemi të bëjmë me apelativin e shqipes malet në shumësin e singularizuar, pluralia tantum, e jo me apelativin sllav malot me kuptim, i vogël.

Në rrethinën e Tetovës në regjistrat e shekullit XV del i regjistruar toponimi mesjetar me emrin Prushefc,<sup>47</sup> e jo me formën e sotme sllave të shtrembëruar në atë Pershevc, nga forma latine pirus-prush me prapashtesën sllave-efci si edhe vendbanimet Zgurofc,<sup>48</sup> dhe Zoganofc<sup>49</sup> e shumë të tjera më bazën e protoshqipes dëshmojnë se ato janë krijuar para vendosjes së administratës sllave-bullgare dhe asaj serbe në hapësirën e Maqedonisë së sotme.

Përveç dëshmive të toponomastikës historike për të dëshmuar praninë e popullsisë shqiptare në mesjetë, në hapësirën gjeografike të Maqedonisë sotme, pikërisht gjatë shekullit XV kemi të dhëna të mjaftueshme antroponimike që na ofrojnë defterët osmanë .Nuk ka as më të voglin dyshim se popullsia albane që ka banuar edhe para shekullit XV dhe në mungesë të regjistrimeve më të hershme, këto fakte dita ditës po i dëshmojnë të dhënat arkeologjike, linguistike dhe toponomastike. Ne, kësaj radhe kemi nxjerrë të dhëna antroponimike dhe patronimike të kryefamiljarëve me prejardhje albane si zot të shtëpive të tyre që gjatë shekullit XV ishin të detyruar t'i shlyejnë taksat e ndryshme dhe tatimet fiskale ndaj administratës osmane në vendbanimet e tyre, kjo do të thotë se këta kryefamiljarë ishin banorë të përhershëm dhe jo nomadë

43 BOA. Rumeli tapu tahrir defteri nr. 12 Turски документи за исторijata на makedonskiот народ-opsiren popisen defter od XV vek, tom III. Arhiv na Makedonija, Skopje, 1976. f. 218. TD, tom-I, Nr. 4, f. 474.

44 BOA. Tapu tahrir defteri nr. 12. Turски документи за исторijata на makedonskiот народ-opsiren popisen defteri od XV vek, tom III. Arhiv na Makedonija, Skopje, 1976. f. 240.

45 BOA. Defter-i esami-i vojngugan-i liva-i Kunstendil ve Alaca Hisar ve Iznepol, nr. 21, f. 137.

46 TKA. Ankara. Defter-i mufassal-i liva-i Kunstendil, nr. 85. Turски документи, tom V, Shkup, f. 562.

47 BOA. Defter-i mutassal-i liva-i Uskup sene. 886 1481, Nr. 16M, f. 191-192.

48 BOA. Turски документи, tom.III, f. 205, TD, tom-I, Nr. 4, f. 460.

49 BOA. Turски, документи, tom. III, f. 75, TD, tom-I, Nr. 4, f. 379.

ose endacakë që lëviznin prej një vendi në tjetër vend. Nuk ka as edhe një dëshmi dhe as një rast që pranë qindra kryefamiljarëve albanë të regjistruar në këto burime zyrtare arkivore që mbanin emrat e sferës së antroponimisë së huaj të llojllojshme: latine-romane, geko-bizantine, sllave-bullgare ose orientale të jetë shënuar pranë individit me etnonimin Arbanas ose Arnaut, apelativi sllav: doshllac, prishllac, uselica, emigrant që do thotë se kryefamiljarët shqiptarë me këtë etnonim si: Petro Arbanas, Dimitri Arbanas, Nikolla Arbanas, Bogdan Arbanas, Bogoslav Arbanas, Milosh Arbanas, Bozhidar Arnaut, Gjuro Arbanas, Mihajl Arbanas, Todor Arnaut, Andreja Arnaut, Lzar Arnaut apo Jusuf Arnaut ose Hamza Arnavut etj, nuk janë shënuar me cilësorin sllav doselic ose prishlec, çka dëshmon se ata ishin vendës në vendbanimet e tyre dhe etnonimi popullor si i tillë natyrisht se tregon edhe përkatësinë etnike, por më tepër në kontekstin kohor. Ky etnonim paraqiste statusin shoqëror të individit për t'u dalluar nga individët e tjerë pa pozita, njësoj, siç është përdorë epiteti për etnitë tjera: Dragoslav Serbin, Bozidar, Bulgarin, Dançul, Vllah, Janos Grek (t.Rum) etj. Mirëpo, shpeshherë etnonimi popullor është përdorur edhe në funksion të patronit ose mbiemrit, si Bogdan i biri Arbanasit, Milosh i biri Arbanasit, Stanisha i biri Arbanasit, Novak ibiri Arnautit, Mark i biri Arnautit etj, dhe kjo dukuri nuk mund të përdoret si argument për të dëshmuar se vetëm individët me etnonimin Arbanas dhe Arnavut, përbënin pakicën e popullsisë albane në mesin e popullsisë shumicë që mbanin emra sllavë ose me emra krishtero-sllavë, për të përcaktuar strukturën etnike të popullsisë së përgjithshme heterogjene, siç mendojnë disa studiues sllavë sepse në të njëjtat vendbanime, ku kishte individë me këtë etnonim, kishte edhe kryefamiljarë tjerë albanë që mbanin emra tipikë sllavë në simbiozë me mbiemra karakteristikë që e përcaktojnë karakterin etnik të albanëve mesjetarë si: Bogdan Bardo, Radislav Bardo, Drajko Bardo, Bogoslav Gjoni, Bozhidar Gjegji, Vukashin Leshi, Bogdan Progoni, Radislav Gjini, Gjuro Gjoni, Stepan Bardo, Petri Gjoni, Dimitri Gjini, Stane Gjonbardi, Lazor Muzak, Todor Tanushi, Andreja Leshi, Aleks i Muzak, Hamza Bardi, Jusuf Gjoni etj.

Duhet theksuar edhe faktin tjetër se edhe pranë kryefamiljarëve tjerë të albanëve që mbanin emra dhe mbiemra karakteristikë ose kalendarikë tradicionalë albanë, si Bard, Bardh, Lul, Tanush, Mazrek, Muzak, Gjini, Gjon, Simon, Lesh, Andre, Aleks, Petri, Dimitri, Mihal, Filip nuk ishin cilësuar me atributin doshllac ose prishliç si banorë të ardhur, sikurse banorët me emra tipikë sllavë, përveç në raste shumë të rralla dhe këto raste ishin prej një fshati në fshatin tjetër në fqinjësi dhe jo prej një rajoni apo vilajeti të largët dhe në asnjë rast nga Arbanoni qendror mesjetar. Këto të dhëna të regjistrave osmanë dëshmojnë se popullsia albane ishte

vendase dhe jetonte edhe para depërtimit osman në këto vendbanime të Maqedonisë sotme. Po të kishe pasur migrime të mëdha të popullsisë në brendinë e hapësirës së Ballkanit, ka qenë e pamundshme që administrata osmane të mos ta kishte shënuar fenomenin e migrimeve të popullsisë së asaj kohe meqë për migrimet individuale sllave, defterët ofrojnë të dhëna.

Po ashtu, nuk ka kurrfarë të dhënash për gjoja migrimet e popullsisë albane nga Arbanoni qendror mesjetar nga Jugu drejt Veriut gjatë Luftës (1683-1690) që u zhvillua në mes të Austrisë dhe Perandorisë Osmane, që sipas tezës së shpikur dhe të falsifikuar të historiografisë serbe deri në atë kohë kinse s'ka pasur popullsi albane në hapësirën e Maqedonisë së sotme dhe të Kosovës. Studiuesit e mirëfilltë të Republikës së Maqedonisë duhet të heqin dorë nga kjo tezë e falsifikuar dhe nacional-shoviniste të fabrikuar në arsenalin propagandistik të historiografisë borgjeze dhe të asaj bashkëkohore serbe, meqë kjo tezë qysh moti është zhvlerësuar dhe demantua nga studiuesit e huaj dhe vendas. Përkundrazi ka ndodhur e kundërta ku sipas defterëve osmanë gjatë shekujve XV-XVI ka pasur lëvizje dhe migrime jo masive, por individuale të popullsisë sllave nga Lindja dhe Verilindja në drejtim të Perëndimit kah tokat e banuara me popullsi shumicë albane, pikërisht në Maqedoninë Perëndimore dhe Veriperëndimore, po ashtu edhe në Kosovë. Në regjistra osmanë janë shënuar shumë familje sllave me apelativat sllavë si doshlac, prishlac, uselica si banorë ardhacakë edhe këto të dhëna janë një indikator që popullsia sllave kishte depërtuar më vonë në trojet, kryesisht të banuara me popullsi të krishterë albane..

Një fenomen tjetër që deri me sot nuk është hulumtuar sa duhet, ku në të njëjtën kohë gjejmë të regjistruar banorë albanë si në vendbanimet me shumicë banorë të krishterë si në ato lagje dhe vendbanime myslimane posa ishin formua, ku albanët e besimit të krishterë edhe pas kalimit në islam i merrnin emrat myslimanë, ndërsa shpesh herë i mbanin mbiemrat e të parëve të tyre të krishterë, çka mundëson deri në një farë shkalle të nxirret përkatësia etnike dhe fetare e popullsisë albane, gjatë shek. XV-XVI.

Pas vendosjes së administratës osmane fillon gradualisht të ndërpritet sllavizimi, jo vetëm në aspektin onomastik, por edhe në atë etnik të popullsisë albane. Pothuajse nuk ekzistonte emër i sferës së antroponimisë sllave që gjatë sundimit mesjetar bullgar dhe atij serb që nuk e kanë mbajtur edhe popullsia e krishterë albane e Maqedonisë dhe e Kosovës, ku onomastikoni sllav ju kishte imponuar me dhunë nga administrata e sidomos nga kisha pravosllave, meqë nuk u lejohej familjeve albane që fëmijët e tyre t'i pagëzonin me emrat e tyre karakteristikë ose me emra të gurrës shqipe, se gjoja emrat josllavë ishin në kundërshtim me ligjet

e kishës pravosllave. Është i njohur Kodi famëkeq i mbretit serb për përndjekjen dhe persekutimin e albanëve të besimit katolik, meqë riti katolik konsideroheshin herezi, ndërsa katolikët si jobesimtarë të vërtetë. Si duket albanët katolikë qysh atëherë kanë praktikuar laramanizmin edhe me emra të imponuar sllavë, në dukje të jashtme me formalitete dhe tipare sllave, meqë kanë qenë të trajtuar si heretikë, ndërsa fshehurazi e kanë praktikuar ritin katolik, njësoj sikurse edhe gjatë sundimit osman, formalisht kanë marrë edhe emra myslimanë, përveç emrave të fshehtë të krishterë, ditën ju kanë përshtatur adeteve myslimane, e natën fshehurazi janë lutur sipas zakoneve të ritit katolik.

Në një krisobulë të mbretit serb Dushanit thuhet se edhe arbanasët duhet të shkojnë në kishat sllave të punojnë dhe të përshtaten sipas zakoneve sllave-serbe.<sup>50</sup> Sepse kishat katolike gjatë sundimit serb ishin uzurpuar dhe shndërruar në kisha pravosllave. Edhe kishat ortodokse të ritit greko-bizantine u shndërruan në ato të ritit pravosllave, meqë mesha, pagëzimet, lutjet dhe shërbesat tjera bëheshin në gjuhën e vjetër ruso-sllave. Këto ndryshime nuk u mirëpritën nga popullsia vendase josllave e cila gjatë tërë kohës së sundimit të administratës së Dinastisë së Nemnjqëve është përndjekur dhe persekutuar.

Burimet mesjetare ofrojnë dëshmi edhe për ekzistimin e manastireve dhe kishave mesjetare të popullsisë së krishterë albane, si të ritit latino-roman ashtu edhe të atij greko-bizantin para vendosjes së administratës sllave në tokat e banuara me popullsi albane. Në Ohër ka ekzistuar kisha e Shën Mërisë, më parë e quajtur Shën Klimenti e ndërtuar në vitin 1295 nga Progon Zguri,<sup>51</sup> me origjinë albane, i cili në atë kohë e kishte oficinë e lartë bizantin, heteriarku i madh, andaj këtu bëhet fjalë për një fisnik të lartë për vetë dhëndrin e perandorit bizantin, të Andronik Paleologut (1282-1328).<sup>52</sup> Siç shihet, Ohri ishte qendër e madhe ortodokse dhe kishte rëndësi edhe për rajonin më të gjerë si edhe për fisnikët albanë që për një kohë të gjatë i shtrinë zotërimet e tyre administrative në këto anë. Në Ohër ekzistonte kisha e Shën Nikolla Arbanashki e shekullit XIV, pastaj Manastiri i Shën Gjergjit afër Shkupit, ku frekuentonin albanët e krishterë. Në vitin 1343<sup>53</sup> në një dokument sllav thuhet se mbreti Dushan në themelet e vjetra e rindërtoi kishën ortodokse të Tetovës dhe në këtë kohë ai u kishte ndaluar albanëve që ta shfrytëzojnë malin në vendin e quajtur Nanonvdol. Në fund të shek. XIII, mitropoliti i Prizrenit Gjeorgji Markos, lidhur me kontestin e një prone të kishës së lartpërmendur të Tetovës që gjendej në kodrën e quajtur Pllesh që e kishte uzurpuar një individ

50 St. Novakovic, *Zakonski spomenici*, SKA, Beograd, 1912, f. 697.

51 J. Ivanov, *Bulgarski Starini iz Makedonija*, Sofija, 1931, f. 38.

52 Ylber Hysa, *Shqiptarët dhe të tjerët*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2009, f. 120.

53 Gasper Gjini, *Skopsko-Prizrenska, Biskupia, kroz stoljeća*, Zagrep, 1986, f. 99.



me emrin Progon, mirëpo mitropoli në fjalë këtë mosmarrëveshje e kishte zgjedhur në mënyrë paqësore.<sup>54</sup> Çfarë pozite kishte ky person me prejardhje albane dhe kush ishte ai nuk thuhet asgjë, por me siguri ai kishte një pozitë shoqërore. Kryefamiljarët me emrin Progon kishte edhe në disa vendbanime tjera të Maqedonisë. Në Kratovë<sup>55</sup> në regjistrat osmanë të shek. XV ishte regjistruar Kisha Arnavut. Në defterina nr. 167 të financave dhe timareve për Vilajetin e Rumelisë, në rrethinën e Prespës ishte regjistruar (në emër të priftit ortodoks me origjinë albane), Manastiri i pop Gjergji-t me formën shqipe e jo me atë sllave. Gjorgje apo Georgije. Në verilindje të Kosovës në rrethinë të Leskovcit sipas defterëve osmanë të shek. XV-XVI kanë ekzistuar 2 manastire albane, njëra me emrin Manastiri Sveti Arbanas<sup>56</sup> e tjetri me emrin, Manastiri Arnavut.<sup>57</sup> Shen Nikolla të braktisura pa asnjë prift, por të ardhurat nga pronat e këtyre dy manastireve ishin regjistrua në kuadër të timareve të spahinjve osmanë. Sipas burimeve sllave qysh në shekullin XIV ka ekzistuar kisha Sveti Nikolla<sup>58</sup> në Prizren e ndërtuar nga fisniku Rajko Krizmiq (Krizma) i ati i fisnikut Bogdan Krizmiq (Krizma) me prejardhje albane. Bogdan Chrissima nga Prizreni, në burimet e Arkivit të Raguzës përmendet në fillim si tregtar i madh e pastaj edhe si ministër i Financave në administratën e despotit serb. Këtë të dhënë lidhur me donatorin e kësaj kishe, autorët serbë s'e kanë përmendur asnjëherë as publikuar, meqë ndërtuesit e kësaj kishe i kanë konsideruar në aspektin etnik si serb në bazë të emrave Rajko dhe Bogdan, por patronimi i tyre karakteristik tregon qartë prejardhjen e tyre albane dhe procesin e sllavizimit të antroponimeve albane. Ky burim sllav tani për herë të parë bëhet publik.

Si dëshmi tjetër për praninë e albanëve në territorin e Maqedonisë së sotme ishin edhe spahinj të vendas me prejardhje albane e jo të ardhur nga Arbanoni politik mesjetar, që më parë kishin kaluar në fenë islame dhe ishin inkuadruar në sistemin e timarit të spahinjve osmanë. Sipas defterëve të shek. XV (1451/53 dhe 1467/68) ata i kishin timaret e veta në territorin e Maqedonisë dhe të Kosovës, kësaj radhe po i përmendim vetëm disa prej tyre: Hamza Arnauti<sup>59</sup> nga mëhalla Mentesheli e Shkupit e kishte timarin e vet në fshatin Gumaleva. Hamza Arnauti, (tjetër) nga vendbanimi Niçevo (Nokova) e Shkupit kishte timarin e tij në fshatin Pagarusha, Jusuf Arnauti nga fshatm Topçe Is'akli afër Draçevës së Shkupit. Shahin

54 R. M. Grujić, *Poloshko -Tetovska Eparhija i Manastir Leshak*. GSND. 12. Shkup. 1933. f. 48. Gasper Gjini, vep. e cit. f. 99.

55 Aleksandar Stojanovski, *Turski dokumenti za istorijata na Makedonija*. Shkup. 1974.

56 BOA. Tapu timar defteri nr. 404.

57 BOA. Tapu timar defteri nr. 404.

58 Zaduzbine Kosova. Spomenici i znamenja srpskog naroda- Prizren. Beograd. Shtampa CGP. Ljubljana. 1987. f. 505-514.

59 BOA. Turski dokumenti Nr. 4. f. 41.

Arnauti dizdar i kalasë së Shkupit i kishte timarin në tri fshatra të Shkupit. Jusuf Arnauti nga Tetova, kishte ziametin e tij në vilajetin e Tetovës,<sup>60</sup> Ali Prishtina e kishte timarin në fshatin Banjic të Poshtme,<sup>61</sup> që i takonte Shkupit, Ferhat Arnauti<sup>62</sup> e kishte timarin në fshatin Nikiforovo që i takonte Tetovës, Behaidir Arnauti, me prejardhje nga fshati Poroj (Prroj) i Tetovës së bashku me djemtë e tij Hamzën dhe Aliun e posedonin një timar në fshatin Stublla të Vitisë së Moravës. Ky spahi vendas me emrin Behadir sipas defterit të Rumelisë të vitit 1451-53 ishte regjistruar në fshatin e lartpërmendur në mesin e kryefamiljarëve të tjerë të krishterë i vetmi që e kishte marrë emrin mysliman Behadir i biri i Shoq-it. Në këtë vendbanim ishte regjistruar edhe Nikolla i biri i Arnautit dhe Nikolla i biri i Shoq-it. Siç shihet Behadiri ishte farefis me Nikolla Shoq-in, çka dëshmon se ata ishin vendas të krishterë të këtij vendbanimi, meqë paguanin ispenxhen dhe taksa të tjera. Patronimin Shoqi haset edhe në krisobulat sllave të shek. XIV si edhe në defterët e tjerë që ka kuptim vetëm në gjuhën shqipe. Ndërsa përgatitësit e defterit, M.Sokoloski dhe A.Stojanovcki nuk kanë arritur ta deshifrojnë këtë patronim tradicional të apelativit të shqipes, duke e transkribuar gabim si: Shuko, Shko dhe Surgo, që nuk jep kurrfarë kuptimi. Këtë patronim të familjeve albane e hasim edhe në fshatin Vrutok,<sup>63</sup> të Gostivarit si Zaharie i biri Shoq-it. Po ashtu edhe në qytezën e Gostivarit e hasim kryefamiljarin Nikolla i biri i Shoq-it, Dejan dhëndri i tij, si edhe në fshatin Jedrovci,<sup>64</sup> vendbanim i panjohur, kemi kryefamiljarin Radoslav i biri Shoq-it, Petko, i biri i tij (Shoq-it) Ivan i biri i Shoq-it, Niko i biri i tij (Shoq-it). Këtu kemi 5 kryefamiljarë me emra të formave sllave në farefisni me stërgjyshin e tyre që e mbante patronimin alban Shoqi. Vetëm në raste të këtilla mund të identifikohen kryefamiljarët me prejardhje albane, kur i mbanin emrat dhe mbiemrat karakteristikë apo tradicionale të onomastikës albane.

Në vijim po japim edhe disa të dhëna për spahinjtë e krishterë me prejardhje albane që i kishin timaret e veta së bashku me individë të tjerë, në simbiozë me antroponimi sllave në rrethinën e Shkupit ku shihet se edhe këta ishin vendas, meqë në defterë posaçërisht theksohet se këta individë ishin spahinj të vjetër, çka kuptohet se edhe para viteve 1467-68 në regjistrimet e mëhershme që nuk janë ruajtur i kanë pasur timaret e tyre.

Timari i Mirashit të birit të Todorit, i Dobroslav-it i të birit të Jaroslavit, i Kojçinit i të birit të Gjonit ,.....( dhe 4 individë të tjerë ). Timari i Gjures i biri i Todorit , Petko i vëllai i Ibrahimit, Gjoni i vëlla

60 BOA. Turski dokumenti, tom VI, f. 320-332.

61 BOA. Turski dokumenti, tom VI, f. 379.

62 BOA. Turski dokumenti, tom VI, f. 283.

63 BOA. Turski dokumenti, tom III, f. 119.

64 BOA. Turski dokumenti, tom III, f. 206.

i Petko (Ibrahimit), Gjura i biri i Petko (Ibrahimit) dhe Lazori i biri Petko (Ibrahimit). Timari Hamzait i vëlla i Ibrahimit, Gjoni i vëlla i Hamzait të vëllait të Ibrahimit. Nikolla i vëlla i tij Gjonit. Pavli i biri i Mihos. Pejo i biri i Pavlit. Petko i biri i Gjonit i vëllai i Hamzait të vëllait të Ibrahimit.

Për të gjithë këta timariotë thuhet në defterë se ishin spahinj të vjetër dhe çdo vit njëri prej tyre është i obliguar të shërbejë në ekspedita ushtarake. Të gjithë këta individë-spahinjë ishin në lidhje të ngushtë të gjakut edhe pse mbanin emra të ndryshëm, heterogjenë shumica prej tyre ishin me përkatësi etnike albane.<sup>65</sup> Hasim edhe raste të tjera ku të krishterët me prejardhje albane edhe nga Kosova që kishin kaluar në islam, kishin fituar timaret e tyre.

Timari i Hamzait<sup>66</sup> (tjetër) i vëlla i Jovanit nga fshati Dolna Tushimla e (Poshtme) që ishte shënuar në defter se ishte bërë mysliman dhe ishte me origjinë nga Vilajeti i Vëllkit-Vushtrisë. Në këtë fshat del të përmendet edhe Novaku i biri i Arnautit (Arbanas) që ishte në lidhje të gjakut me Jovanin dhe Hamzain. Timari i Nikolles i vëlla i sharapdarit të Zoganosit, që ishte kushëri me Zoganosin e Çeribashit të Vuçitërnës. Të dy këta spahinj ishin në gjini të gjakut dhe timaret e tyre i kishin në nahijen e Vuçitërnës.<sup>67</sup>

Mustafa<sup>68</sup> i vëlla i Gjergjit, së bashku me disa individë të tjerë e posedonte timarin në fshatin e Moravës të dhënat e sipërme na dëshmojnë se albanët e Kosovës edhe të Maqedonisë së sotme i takonin edhe rritit ortodoks. Timari i Mustafait i biri i Gjon Kisarit përfshinte 2 fshatra Boreshnicën dhe Banjicën në rrethinën e Relinit.<sup>69</sup>

Haset e subashit të Ali Beut, sipas defterit të vitit 1451-53,<sup>70</sup> përfshinin 23 mëhalla myslimane. 8 mëhalla të krishterë dhe 20 fshatra në Vilajetin e Shkupit. Në vitin 1487<sup>71</sup> ziameti i tij përfshinte 27 vendbanime në nahijen e Vuçitërnës dhe Moravës.

Ky Ali Beu si duket është identik me Gazi Ali Beun sipas një dokumenti,<sup>72</sup> që ruhet në Arkivin Osman në Stamboll, ishte i vëllai i Isa Beut dhe i biri i Evronos Beut i cili ishte me prejardhje albane, të cilit sulltani në vitin 1462 ia kishte besuar qeverisjen me sanxhakun e Vuçitërnës, prandaj ai del si fisnik vendas i trojeve albane. Kemi edhe shumë spahinj tjerë me prejardhje albane si: Ali dhe Hamza Kërçovali, nga Kërçova. Shimerd Vardarli i Shkupit. Mahmud Manastirli, Ali Arnauti etj. shihet qartazi se këta posedues të timareve, ishin nga trojet e sotme të

65 BOA. Turski dokumenti, tom I-Nr. 4, f. 513.

66 BOA. Defter-i mufassal-i liva-i vilajet-i Vilk. Nr. 2. Oblast Brankovica. Knjiga. I Sarajevo 1972. f. 61.

67 BOA. Defter-i mufassal-i liva-i vilajet Vilk. Nr. 2 Oblast Brankovica. Knjiga. I Sarajevo 1972. f. 96-97.

68 BOA. Defter-i mucmel-i liva-i Vileciterin. Nr. 22.

69 BOA. Turski dokumenti, tom II f. 288

70 BOA. Turski dokumenti, tom III, f. 157-180. (me tej citojmë vetëm me shkurtësën: BOA.TD, tom II, III, IV, dhe V).

71 BOA. Defter-i mucmel-i liva-i Vileciterin. Nr. 22

72 BOA. Evrak evkafi, Dosya 10, Gomlek Nr. 1, vesika 2, varak 10, tarih. 861H 1456-57.

Maqedonisë e jo të ardhur nga Shqipëria Qendrore e sotme.

Lidhur me këtë temë shih edhe punimin e Dr. Ramiz Abdylit të bazuar në të dhënat e defterëve osmanë të shek. XV-XVI të botuar në vitin 1994.<sup>73</sup>

Si dëshmi për praninë e popullsisë albane mund të merren edhe elementet e karakterit gjuhësor, ku në defterë shumë kryefamiljarë përveç që janë shënuar në shumicën e rasteve, me format sllave: Petko Arbanas, Lazar Gjergjo, Gjon Bojko, Mirko Gjinko, Mhaji Prenko, Dabzhiv Tushko, Radoslav Leshko, Marko Pulo etj., janë shënuar, por më pak edhe me forma të shquara të shqipes, si: Petri, Petro, Dimitri, Aleksi, Gjergji, Gjorgji, Jorgji, Lazor për Lazër, Mihal, Vasil, Rad, Radi, Vlad, Boja, Biba, Daba, Mana, Pepo, Rela, Kala, Tusha e shumë të tjerë. Duhet theksuar se shumë antroponime dhe patronime të kryefamiljarëve me origjinë albane nuk janë lexuar dhe transkribuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë, ndërsa disa prej këtyre patronimeve janë shtrembërua nga ana e deshifruesve të këtyre defterëve, duke u dhënë antroponimeve dhe patronimeve albane, forma dhe prapashtesa sllave që nuk janë shënuar në defterët origjinalë. Kështu që, në shikim të parë duket se fare pak kishte kryefamiljarë me origjinë albane, por nëse shikohen origjinalet e këtyre defterëve të përkthyer nga deshifruesit në fjalë, atëherë shihet se këta kryefamiljarë albanë ishin shumë më shumë se sa janë dhënë në përkthimet e këtyre defterëve dhe në disa vendbanime edhe pse ishin në simbiozë me shumë emra sllavë, albanët së bashku me arumunët përbënin shumicën e popullsisë, sidomos në Maqedoninë Perëndimore. Gabime serioze ka edhe në deshifrimin e disa mikrotoponimeve që duhet përmirësuar me rastin e ribotimeve të 2 defterëve më të vjetër. Po të ishin botuar krahas përkthimeve edhe origjinalet, pikërisht faksimilet e tyre që e kërkon metodologjia shkencore, atëherë specialistët e paleografisë osmane do të kishin mundur më lehtë ta bënë verifikimin dhe vlerësimin e deshifrimeve të këtyre defterëve, që në shumicën e rasteve janë të shkruara pa shenja diakritike. Së këndejmi këta defterë të botuar në këtë mënyrë, jo vetëm që nuk janë shumë të besueshme, por deshifrimet e tilla janë të kontestueshme dhe në shumë raste edhe të papranueshme. Meqë, nuk kemi mundësi të riprodhojmë grafinë arabo-osmane, në këtë rast po paraqesim vetëm disa shembuj prej qindra shembujve tjerë ku antroponimet dhe patronimet e kryefamiljarëve albanë nuk janë deshifruar në mënyrë të saktë: Burtnik si Tornik, Drralla si Drale, Binush Pinush si Penush, Tominiko si Pomenko, Gjergji - Gjergjo si Gergi-Gergo, Gura-Guri si Gjure dhe Gure, Gjini-ko si Genko, Gjinish si Gijash, Gjinguri si Kenguri?! Gjon-ko si Gonko, Gjon-ash si Gujash,

<sup>73</sup> Ramiz Abdylit, Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve të shek. XV-XVI në librin "Shqiptarët e Maqedonisë" 1994, f. 133-144.

Jan-o-Janko. Muzak në shumë raste si Mozak-Mizak, Mezak, Mardoç-i si Mordoç. Lazor si Lazar, Les si Leshko, Petro si Pero, Pashko-si Tashko, Pren-ko si Trenko. Prençe si Trençe, Peshkop-Skubo. Prush-o si Prosh-o, Pulo si Bojo?! Rad si Rade, Jan-Tan si Pane, Tanush në shumë raste si Panush dhe Banush, Shoq-Shoqo si Shuk , Shuko-Sh-k-o etj.

Siç shihet nga të dhënat onomastike që na ofrojnë defterët e shekullit XV dhe XVI kryefamiljarët me përkatësi albane si zot të shtëpisë, përveç antroponimeve dhe patronimeve të pakta karakteristike që kishin arritur mezi t'i ruajnë me fanatizëm, ata gjatë mesjetës nën sundimin bullgar e pastaj atij serb më së shumti kanë mbajtur antroponime tipike sllave dhe të krishtera të formave sllave, meqë administrata dhe kisha sllave ua kishte imponuar. Nga këto të dhëna kuptojmë se popullsia albane gati krejtësisht në aspektin onomastik ishte sllavizuar. Për këtë arsye onomastika sllave që në mesjetë haset dendur në vendbanimet e banuara me popullsi albane në hapësirat e Maqedonisë sotme, të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Shqipërisë Verilindore nuk mund të merret në mënyrë të prerë dhe absolute si kriter apo indikator për të përcaktuar karakterin etnik të kësaj popullsie, pa i marrë në konsiderim dhe pa i shpjeguar rrethanat dhe kushtet historike që ndikuan në përhapjen e antroponimisë sllave tek popullsia albane. Nuk ka kurrfarë dyshimi se të gjitha vendbanimet e Maqedonisë së sotme perëndimore dhe veriperëndimore në mesjetë ishin të banuara me shumicë me popullsi të përkatësisë albane, popullsi kjo që ishte e veshur gati krejtësisht me antroponimi krishtero-sllave dhe pjesërisht në simbiozë me atë krishtero-albane. Në këto vendbanime hetohet qartë edhe prania popullsisë arumune (vllëhe) me përmasa të vogla e cila ishte sllavizuar jo vetëm në aspektin onomastik, por dhe në atë etnik. Popullsia vllëhe meqë ishte në krahasim me popullsinë albane pakicë, nuk mundi dot t'i rezistojë sllavizimit as në Maqedoni as në Kosovë dhe as në Serbi. Popullsia albane arriti në masë të konsiderueshme t'i ruajë patronimet karakteristike dhe etnonimet e fiseve dhe të vëllezërve që vetëm në bazë të tyre dhe lidhjes së gjinisë së tyre mund ta përcaktojmë përkatësinë e tyre etnike. Por, siç e kemi theksuar edhe më herët për shumicën e popullsisë albane, për shkak të rrethanave politike dhe historike, që u vesh me antroponime tipike sllave, andaj përkatësia e saj etnike, gjatë mesjetës nuk mund të përcaktohet saksish. Kjo popullsi edhe pse në aspektin onomastik duket si sllave, por në aspektin etnik ishte albane, e joslave. E njëjta panoramë antroponimike na paraqitet kur prej shekullit XVII shumica e popullsisë albane e pranoi fenë islame dhe u vesh me emra të onomastkonit oriental-islam e tërë popullsia albane, në bazë të këtij onomastikoni oriental nga kronistë të huaj konsiderohej popullsi turke, duke e identifikuar karakterin etnik me

atë shtetëror, meqë faktikisht ishte nënshtetase e Perandorisë Osmane, por në esencë në aspektin etnogjuhësor nuk ishte turke, por popullsi albane. Këtë fakt historik historiografia sllave nuk do që ta pranojë, se atëherë do ta pranonte realitetin historik se edhe gjatë sundimit mesjetar bullgar dhe atij serb në Kosovë e Maqedoninë e sotme popullsia albane përbënte shumicën. Këtë fakt nuk e pranojnë, meqë qarqet e caktuara nacionaliste sllave, gjithnjë kanë pretendime territoriale ndaj trojeve të banuara me shumicë me popullsi albane.

Një grup pseudoshkencëtarësh sllavë të Maqedonisë në krye me Riste Blazhevski kohëve të fundit po pretendojnë dhe po mundohen t'i mohojnë faktet historike dhe argumentet shkencore, e sidomos burimet arkivore dhe defterët zyrtarë kadastralë të administratës osmane të shekullit XV të pranuar nga studiuesit vendas dhe të huaj, për praninë e popullsisë albane në mesjetë, pra para shekullit XVI në tërë hapësirën e Maqedonisë sotme. Ky grup, mjerisht po shërbehet me tezën e falsifikuar dhe të shpikur nga kuzhina e arsenalit propogandistik e historiografisë nacionalshoviniste serbe, e cila qysh para katër dekadash është zhvlerësua dhe demantua, me zbulimin e gjetjeve të reja arkeologjike dhe dokumenteve të reja arkivore e sidomos të atyre të proviniecës osmane- turke. Këta autorë duhet të distancohen nga teza të tilla nacionalshoviniste që realisht s'kanë bazament në argumentet shkencore empirike të pranuar edhe në shkencën e historiografisë ndërkombëtare. Këta vazhdojnë intelektualë po çojnë ujë në mullirin e qarqeve shoviniste që s'ia donë të mirën as popullit maqedon as popujve tjerë të Maqedonisë. Por jemi të bindur se në Maqedoni ekziston një numër i konsiderueshëm shkencëtarësh dhe studiues të mirëfilltë dhe seriozë që e dinë mirë të vërtetën shkencore, të cilët nuk do të lejojnë që faktet historike dhe argumentet shkencore të shtrembërohen dhe falsifikohen. Njëkohësisht, ata nuk do të lejojnë që shkenca empirike të degradohet dhe të shërbejë për qëllime politike, nacionaliste për të mohuar (pa fakte) autoktoninë e këtij apo të atij kombi dhe për të krijuar situata konfliktuoze ndëretnike që shkojnë në dëm të gjithë qytetarëve të Maqedonisë së sotme multietnike. Shteti një nacional i Maqedonisë sotme është jetë shkurtër dhe jostabil, ndërsa shteti qytetar dhe multietnik i Maqedonisë me të drejta të barabarta politike, gjuhësore dhe kulturore për të gjitha popullsitë e saj, pa dallim etnie dhe feje ka perspektivë reale dhe jetë të gjatë.

Në vijim po sjellim dëshmi arkivore për procesin masiv të sllavizmit të antroponimisë albane dhe njëkohësisht për praninë e popullsisë albane në bazë të patronimeve karakteristike albane në simbiozë me antroponime (emra) sllave, vetëm për disa vendbanime. Prania e popullsisë albane

haset edhe në të gjitha vendbanimet tjera të Maqedonisë Perëndimore dhe Veriperëndimore. Të dhëna më të hollësishme onomastike dhe demografike për vendbanimet tjera do të botohen me një rast tjetër.

Në vendbanimin e Kërçovës, në defterin osman të vitit 1467/68 ishte regjistruar Lagjja e Albanëve, por me formën turke, Mahale-i Arnavut e përfutuar nga forma greke Arvanit-is me anë të metatezës. Në këtë lagje ishin regjistruar edhe këta kryefamiljarë me antroponomi simbiotike arbneshe-krishtere-sllave. ku shihet se të gjithë banorët e kësaj lagje ishin me prejardhje albane me këta kryefamiljarë : Bogdan, i biri i Progon-it; Mijo , i biri i Progon-it;(dy emra sllavë me dy mbiemra mesjetarë albanë) Petri. i biri i Gjonit; Jakin, i biri i Gjinit; Stojan. i biri i Gjonit; Gjini, i biri i Gjonit; Gjergj, i biri i Gjinit; (gjashtë kryefamiljarë në lidhje të gjakut): Niksha i biri i Gjergjit; Petri. i biri i Niko-s; Pejo, i biri i Tushjo-s; Dimitri, i biri i Gjon-it; Vlakshin , i biri i Lesh-ko-s; Stojan i biri i Dança-s; Gjon, i biri i Kosta-s; Todor. i biri i Kostas; Martin, i biri i Kosta-s; Nina, i biri i Todorit; Tadori, i biri i Kosta-s; Martin, i biri i Kosta-s; Nina, i biri i Todorit; Todor i biri i Nikola-s; Gjura, i biri i Doda-s; Gjon, i biri i Doda-s; Oliver, i biri i Doda-s; Stançe i biri i Doda-s (Katër kryefamiljarë një lidhje të gjakut me të parin e tyre Doda); Gjuro, i biri i Martinit; Gjuro, i biri i Blakor-it (Plakor-it); Todor, i biri i Dominiko-s; Nina, i biri i Gjergj-it; Stepan, i biri i Kala-s; Arnaut, plak; Kala e vejë; Pali pa mbiemër; Don-ço. i biri i Niko-s; Mila, i biri i Rrap-ça-s; Ton-ko, i biri i Rrap-ça-s. Edhe në lagjen tjetër që ishte emërtuar si Lagjja Serbe në Kërçovë, disa kryefamiljarë të kësaj mëhalle mbanin antroponimi të krishtere tradicionale albane, në simbiozë me atë sllave: Bojko, i Progonit; Pejo i biri Progonit; Koja, i biri Progonit; Novak i biri Tanushit; Stojko, i biri Dominikut e të tjerë.<sup>74</sup>

#### *Vilajeti i Shkupit (VILAYET-I USKUP)*

Në vijim po i përmendim vetëm disa familje mesjetare albane që kishin arritur t'i ruajnë patronimet e tyre karakteristike të krishtera edhe pas kalimit në fenë islame, siç ishin Gjinajt, Muzakajt dhe Mzrekajt, meqë pjesëtarët e këtyre familjeve i gjejmë të regjistruar edhe në vendbanimet e banuara me banorë të krishterë edhe në ato posa të formuara myslimane në tërë hapësirën e Maqedonisë së sotme. Disa degë të familjeve lartpërmendura që i mbanin për mbiemra emrat e tri fshatrave me emrin Gjinoftë të Qustendilit, të Radomirit, të Shtipit, pastaj të Muzaqës nga Prokupi i Nishit, të Mazaçaevës, të Qustendilit dhe të Mazarikut të Vrajës, shihet se këto familje e kishin prejardhjen nga këto vendbanime e jo nga Arbëria

Qendrore. Këto të dhëna të defterëve e vërtetojnë tezën e medievistëve Jireçek dhe të Shuflaj se depërtimi i popujve sllavë në Ballkan i shtyri të parët e arbanasve më në Jug.

Në regjistrin kadastral osman të vitit 1451/53 në mes të shumë lagjeve tjera, ishte regjistruar edhe lagjja Mahala Gjinko e Shkupit me emërtimin e vëllazërisë mesjetare albane me formën e shtrembëruar sllave, në vend të formës shqipe Mahalla Gjinaj. Kjo lagje emrin e kishte marrë sipas banorit të saj të parë Gjini, këpucëtarit (Gjin-ko, papuxhi) që në atë kohë ushtronte zejen e këpucëtarit në dyqanin e tij. Në mesin e 58 kryefamiljarëve të kësaj lagjeje që kishin antroponimi simbiotike krishtere-sllave dhe albane ishin regjistruar edhe këta kryefamiljarë: Gjini-ko papuxhi, Todori, i vëllai i Gjinit; Nikolla, i biri Sapat-it (Sopat); Dragoslav, i biri i tij; Dimitri, i biri Prenç-es (Prenk); Nikolla, i biri Jon-çës, Dragan, i biri Mala (Malja); Nikolla, i biri Drrala; Drrala, i biri Mark-ut; Stepan, i biri Bertoris-it; Nikolla, i biri Bertoris-it.<sup>75</sup>

Në defterin e vitit 1467/68, 16 vjet më vonë në lagjen Gjini-ko, (Gjinaj . I.R), e gjejmë të regjistruar të birin e këpucëtarit të lartpërmendur Mark, i biri Gjini-ko-s dhe kryefamiljarët tjerë : Dimitri, i biri Mitresh-it; Nikolla, i biri Gjeshaliç-it; Todor, i biri Mirush-it; Rela, i biri i Sapat-it (Sopatit), Todor, i biri Liko-s.<sup>76</sup>

Paleografët nga Shkupi prof. M. Sokoloski dhe dr. A. Stojanovski nuk kanë arritur që këtë ligaturë të paleografisë osmane të këtij mikrotoponimi ta lexojnë në mënyrë të drejtë dhe të saktë, duke dhënë transkribimin e tij në formën e shtrembëruar si Maalo Genko në vend të formës së drejtë turke Mahalle-i Gjini-ko, që rrjedhë nga patronimi Gjinaj i vëllazërve dhe familjeve fisnike mesjetare albane të Gjinajve që përmendën qysh në shekullin e XIV në dokumentet sllave si dhe në defterët osmanë të shek. XV të degëzuara dhe të shpërndara nëpër shumë vendbanime në territoret e Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe të Serbisë Jugore, duke u shtrirë në një hapësirë edhe më të gjerë deri përtej Radomiri dhe Qystendili të Bullgarisë. Natyrisht se disa degë të këtyre vëllazërve rrjedhin nga vendbanimet mesjetare të Gjinajve që banonin në trekëndëshin Qystendil- Shtip- Shkup, por që gjatë sundimit mesjetar bullgar (850-927-1018), ato u shtynë më në perëndim, në brendi të tokave albane, e disa prej tyre u sllavizuan plotësisht. Një degë e kësaj vëllazërie rrjedhë pikërisht nga vendbanimi mesjetar Gjinofo që gjendej në majat e Malësisë së Karadakut mbi fshatin e sotëm të Stubllës së Vitisë. I cili në defterë osmanë të shek. XV përmenden vetëm me dy shtëpi. Një tjetër vendbanim del të përmendet në shekullin XVI me emrin Gjinofo

75 BOA-TD. III. f. 164-65.

76 BOA-TD. Nr. 4. f. 421.



Kulla, diku në afërsi të Nova Bërdës ku ekzistonte edhe një galeri argjendi. Pas viteve 1556/74 këto dy vendbanime janë braktisur dhe kanë mbetur vetëm topogërmadhat e tyre. Familjet fisnike të Gjinajve ishin ekonomikisht shumë të forta qysh në shekullin XV. Njëra prej tyre posedonte një galeri të metaleve fisnike dhe sipas një shënimi të Ligjit të sasëve për miniera ishte regjistruar një galeri argjendi në zotërim të Gjon Gjinit në fshatin Markofc të rrethinës së Nova Bërdës. Përveç, Gjinofocit të Suharekës dhe Gjonofcit të paubikur, që janë shënuar në krisobulat sllave të shekullit XIV dhe në defterët osmanë të shek. XV-XVI, janë regjistruar edhe tetë vendbanime të tjera në Kosovën Verilindore me këto emërtime. Po kështu edhe në hapësirën e Maqedonisë së sotme në defterët osmanë të shek. XV, janë regjistruar vendbanimet e popullsisë albane: Gjinofoci i Shtipit, Gjinofoci i Kriva Pallankës, Gjonofci i Gostivarit, Gjinova e Tetovës, Gjinofoci i Dibrës, si dhe dy të tjera me emrin Gjinofo, që ishin regjistruar në hapësirën në mes Radomirit dhe të Qystendilit në Bullgari, vendbanime këto që në mesjetë i kishin themeluar vëllezërit e familjeve fisnike të Gjinajve me origjinë albane, para depërtimit të osmanlinjve në Ballkan.

Në lagjen Ahrijan Hasan të Shkupit të vitit 1451/53 ishte regjistruar në mesin e kryefamiljarëve myslimanë edhe kryefamiljari me patronimin e familjes fisnike albane Muzak, që kishte kaluar në islam duke mos e përmendur emrin e tij të më hershëm të krishterë dhe pa e theksuar pozitën shoqërore apo profesionin e tij.<sup>77</sup> Në defterin tjetër të vitit 1467/68 tani në lagjen e krishterë me emrin Svetko Samarxhi të Shkupit, në mesin e 29 kryefamiljarëve me antroponimi krishtere sllave janë regjistruar: Nikolla, i biri Muzak-s; Todor, i biri Shendre-es (Shen Andre-it); Gjuro, i biri Marin it; Jovan, i biri Suteç-it (Suta). Nga këto të dhëna të këtyre dy defterëve shihet qartë, se këta dy kryefamiljarë me mbiemrin Muzaka, njëri i krishterë e tjetri mysliman ishin farefis dhe banorë të vjetër të Shkupit dhe të parët e familjeve të tyre që nga mesjeta e hershme banonin në hapësirat e rajoneve të Nishit, Kosovës dhe të Maqedonisë sotme, pra, para depërtimit osman në Ballkan.

Kryefamiljarët me patronimin e vëllezërve dhe familjeve fisnike Muzak, përveç në Shkup e hasim edhe në disa vendbanime tjera të Maqedonisë së sotme. Në fshatin Ponorisht të Tetovës janë regjistruar kryefamiljarët: Radoslav, i biri Muzak-s dhe Ivan, i biri Muzak-s.<sup>78</sup> Në fshatin Desova të Prilepit ishin regjistruar 3 kryefamiljarë: Muzaka (pa emër); Prodon, i biri Muzak-s; Dobri, i biri Muzak-s.<sup>79</sup>

77 BOA-TD, III, f. 158.

78 BOA-TD, III, f. 41-42.

79 BOA-TD, I-Nr. 4-109.

Në mëhallën Kalçar të qytetit të Prilepit, ishte regjistruar kryefamiljari Dimitri Muzak. Në fshatin Lazheç të Manastirit, ishin 3 kryefamiljarë: Muzak (pa emër); Pejo, i biri Muzak-es, dhe Nikolla, i biri Muzak.<sup>80</sup> Edhe në fshatin Vlashci të Manastirit ishte regjistruar kryefamiljari Muzaka.<sup>81</sup> Në fshatin Novoljani të nahijes së Lerinit ishte regjistruar kryefamiljari Kala i biri Muzak-it.<sup>82</sup> Në fshatin Kalandendra të Serezit, përmendën 4 kryefamiljarë: Miho, i biri Muzak-ut; Jorgji, i vëllai i tij; Nikolla, i vëllai i Jorgjit; Todor, i vëllai i tij (Muzak-es).<sup>83</sup>

Këtë patronim të familjeve fisnike albane e hasim edhe në Toplicë në Prokupje të Nishit edhe si toponim me kompozitën Muzaqeve Kuçe që haset në dokumentet sllave të shek. XIV (1318) si edhe në defterët osmanë në Prokupje është regjistruar vendbanimi Muzaq, pastaj në Kosovë kemi toponimin me formën sllave Muzakov Kusht, afër Strocit të Vushtrrisë. Kryefamiljari Marko, i biri i Muzak-ës në fshatin Meshinoviç (Meshina) në nahijen e Novobërdës<sup>84</sup> si edhe Muzeçina afër Ferizaji. Pastaj vendbanimet: Mazrek te Prizreni, Mazarak te Vranja, Mazaçaeva te Qystendili i Bullgarisë, Muzakoi në Peloponez në Greqi etj. Muzaqët e Bervenikut dhe të Prokupjes së Toplicës, që në burimet sllave quhen Musiçi, që e kishin pasur edhe një minierë të vetën, por ajo ishte uzurpuar nga sunduesit sllavë. Nuk ka dyshim se Muzaqët e Rajonit të Nishit ishin një degë e mbetur nga familjet e shumta mesjetare të Muzakajve, të shpërndara nëpër tërë Ballkanin Perëndimor, që nga koha e sundimit të Bizantit, por që gjatë depërtimeve sllave nuk u dynden në jug të Arbanonit mesjetar, siç ndodhi me një pjesë të popullsisë albane të kësaj ane, por qëndruan në Toplicë të Nishit, të cilët gjatë sundimit mesjetar serb u sllavizuan plotësisht. Muzak Arbanasi i shënuar në burimet narrative sllave si Musa Arbanasi, që sipas epikës popullore mori pjesë në Betejën e Kosovës ishte nga familja e sllavizuar albane e Muzaqëve të Toplicës së Nishit, andaj nuk duhet ngatërruar me fisnikun tjetër Todor Muzakën e II nga Berati, që mori pjesë me një njësi të vetën ushtarake në Betejën e Kosovës.

Në burimet historike greko-bizantine, historia bizantine Ana Komnena qysh në shekullin XI e përmend një fisnik nga kjo familje mesjetare me emrin Muzak, që ishte ndër komandantët më të besuar të perandorit bizantin Aleks Komnenit. Disa anëtarë të kësaj familje gjatë kësaj kohe kanë shërbyer si nëpunës edhe në administratën shtetërore në

80 BAO.TD. II. f. 156.

81 BOA. TD. II. f. 161.

82 BOA. TD. II. f. 332.

83 TD. tom.IV, f. 261-264.

84 BOA. tapu tahrir defteri Nr. 28. Iljaz Rexha, Regjistrimi i vendbanimeve dhe i popullsisë së kazasë së Novobërdës sipas defterit të fundshekullit XV, Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr. (XXVII-XXVIII) Prishtinë, 2002, f. 43-174.

kryeqendrën e Perandorisë Bizantine në Kostantinopolis, në Stambollin sotëm.

